FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.76 **2006**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.445, datë 28.6.2006	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1992……	2195
Vendim i KM nr.450, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet përkatëse", të ndryshuar..……	2196
Vendim i KM nr.455, datë 5.7.2006	Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të industrisë minerare	2198
Vendim i KM nr.456, datë 5.7.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.661, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e shërbimit universitar të ortopedi-traumatologjisë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë"……	2198
Vendim i KM nr.459, datë 21.6.2006	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare……	2199
Udhëzim MPPTT&MF	Për kriteret dhe rregullat e privatizimit të apartamenteve të	2200

nr.3, datë 22.5.2006	ndërtuara me fondet e ish-fondacioneve për familjet që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale…….	
Urdhër i MF nr.27, datë 5.7.2006	Për disa ndryshime në urdhërin nr.2, datë 3.12.2004 "Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit arab Yasin al-Qadi, i njohur dhe si: a) Saykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c)Yassin Kahdi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Addullah Kadi", i ndryshuar……	2201
Urdhër i MF nr.28, datë 5.7.2006	Për disa ndryshime në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 "Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdul Latif Saleh , c) dr.Abd Al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd Al-Latif Salih, f) Abu Amir", i ndryshuar…… ……..	2201
Urdhër i MF nr.29, datë 5.7.2006	Për një ndryshim në urdhrin nr.9 datë 10.3.2005 të Ministrit të Financave "Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Taibah International",e njohur dhe si shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit", i ndryshuar…….....	2202
Urdhër i MF nr.30, datë 5.7.2006	Për një ndryshim në urdhrin nr.10, datë 10.3.2005 të Ministrit të Financave "Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Al Haramania"(Al-Haramain), i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit", i ndryshuar...	2203
Urdhër i MPPTT nr.41, datë 9.5.2006	Mbi zëvendësimin e lejedrejtimeve të automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë……	2203
Urdhër i MMPAU nr.262, datë 15.5.2006	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Prespë)……	2204
Vendim i GJK nr.20, datë 11.7.2006	Me objekt 1. Shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.1.2006 "Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike"; nr.44, datë 27.1.2006 "Për shmangien e nepotizmit në administratën publike" dhe nr.48, datë 27.1.2006 "Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", si të papajtueshëm me Kushtetutën. 2. Pezullimin e vendimeve të mësipërme të Këshillit të Ministrave.…… …….	2204

VENDIM
Nr.445, datë 28.6.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 1992

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 1992.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 1992

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë;

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001,

u morën vesh si vijon.

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një hua me vleftë prej gjithsej 16 412 24 euro (me fjalë: dyqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë euro dhe njëzet e katër cent) për projektin "Rritja e fondit të investimeve sociale ADF II". U konstatua se projekti vjen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një fushe financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozite shoqërore të grave, OSC si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës se Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të tjera të nevojshme për realizimin e këtij projekti, kjo marrëveshje gjen zbatim. KfW gjendet zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis

Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që jane në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërise e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më 1.6.2006 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.450, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", NDRYSHUAR ME VENDIMET PËRKATËSE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", në propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2 vlera "...9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë " zëvëndësohet me vlerën "... 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë";

c) Shkronja "b" e pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b" Në lidhjen 1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nivelet e pagave për emërtesat e mëposhtme shfuqizohen dhe

përcaktohen sipas niveleve të mëposhtme:

- Presidenti 238 855 lekë;
- Kryeministri, Kryetari i Kuvendit 211 710 lekë;
- Zëvendëskryeministri, nënkryetari i Kuvendit 173 710 lekë;
- Ministri 162 850 lekë;
- Deputeti 146 570 lekë;
- Zevendësministri 127 000 lekë;
- Sekretari i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit 53 200 lekë;
- Sekretari i Ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit 42 340 lekë".

ç) Në shkronjën "c" të pikës 7, vlera "...9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë..." zëvendësohet me vlerën "...10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.".

2. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a	10.050	2%	0	120 513
	I-b	10.050	2%	0	108 570
II	II-a	10.050	2%	0	97 713
	II-b	10.050	2%	0	80 342
III	III-a	10.050	2%	0	59 714
	III-b	10.050	2%	0	43 428
IV	IV-a	10.050	2%	0	32 571
	IV-b	10.050	2%	0	21 714

VENDIM
Nr.455, datë 5.7.2006

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË MINERARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë së zhvillimit të industrisë minerare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.456, datë 5.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.661, DATË 25.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSITAR TË ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJISË NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe nenit 16 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.661, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Në pikën 5, fjalët "...brenda vitit 2005..." zëvendësohen me "...brenda vitit 2009…".

b) Pas pikës 6 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Për përballimin e shpenzimeve të tjera operative, për funksionimin e shërbimit të ortopedi-traumatologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë, nga buxheti i vitit 2006, zëri "Shpenzime për mallra e shërbime", t'i zbritet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, i cili të shtohet në buxhetin e vitit 2006, zëri" Shpenzime për mallra e shërbime", miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes. Për vitet e tjera, deri në transferimin e këtij shërbimi nga mjediset e SUQU-së, në buxhetin e çdo viti, që do të miratohet për Ministrinë e Mbrojtjes, zëri "Shpenzime për mallra e shërbime", të parashikohet fondi i nevojshëm për përballimin e shpenzimeve të tjera, për funksionimin e shërbimit të ortopedi-traumatologjisë, përveç parashikimeve për medikamente e materiale mjekimi, të cilat do të parashikohen dhe do të përballohen nga buxheti, që do të miratohet, çdo vit, për Ministrinë e Shëndetësisë.".

2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.459, datë 21.6.2006

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave,

oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension", të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" dhe të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, rriten në masën 2 për qind.

2. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues, në pension, rritet në masën 2 për qind.

3. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve të industrisë ushtarake, rritet në masën 5 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension, rritet në masën 2 për qind.

5. Pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invalidetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", rriten në masën 2 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë, rritet në masën 5 për qind.

7. Rritjen në masën 2 për qind, sipas pikave 1, 2, 4 e 5, të këtij vendimi, si dhe rritjen në masën 5 për qind, sipas pikave 3 e 6 të këtij vendimi e përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara, me datë fillimi deri më 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, llogariten në shumën 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë, dhe do të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINJSTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.3, datë 22.5.2006

PËR KRITERET DHE RREGULLAT E PRIVATIZIMIT TË APARTAMENTEVE TË NDËRTUARA ME FONDET E ISH-FONDACIONEVE PËR FAMILJET QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të vendimit nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve të ish-fondacioneve për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale", Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Kriteret e shlyerjes së vlerës së banesave, investuar me fondet e ish-fondacioneve në Tiranë dhe Vlorë, konform vendimit nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të jenë:

a) Koha e shlyerjes 15 vjet.

b) Interesi vjetor 3,5%.

c) Shpenzimet administrative prej 4% që i mbahen familjes për zbatimin e procedurave të pajisjes me banesë, të llogariten në vlerën që duhet të paguajë qytetari e shtrirë në gjithë periudhën e shlyerjes së kredisë.

2. Vlera e banesës të llogaritet bazuar në:

a) verën e investimit, e përcaktuar në vendimin nr.792, datë 26.11.2003 të Këshillit të Ministrave;

b) vlerën e truallit sipas asetit, që i takon objektit;

c) vlerën e investuar për infrastrukturën;

d) vlerën e pagesave për leje dhe rinovim leje ndërtimi, leje shfrytëzimi dhe regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Mjediset e katit përdhe që nuk janë objekte banimi, të shiten në tregun e lirë sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

4. Vlera nga shitja e ambienteve të katit përdhe të kalojë për mbulimin e vlerës së:

- asetit e cila do të kalojë për llogari të kreditorëve të shoqërisë "Vefa";
- investimit për ambientet e katit përdhe.

5. Në rastin kur fitimi neto, nga shitja e ambienteve të katit përdhe, nuk arrin të mbulojë plotësisht vlerën e asetit, kjo diferencë të merret nga të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamenteve dhe të kalojë në llogari të kreditorëve të shoqërisë "Vefa".

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.27, datë 5.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.2, DATË 3.12.2004 "PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT ARAB YASIN AL-QADI, I NJOHUR DHE SI: A) SAYKH YASSIN ABDULLAH KADI, B) YASIN KAHDI, C)YASSIN KAHDI, Ç) KADI YASSIN, D) YASSIN ADDULLAH KADI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", i ndryshuar,

URDHEROJ:

Në urdhrin nr.2, datë 3.12.2004 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në përmbajtjen e pikës 4, pas pikës 4.36 shtohën pikat 4.37, 4.38, 4.39, 4.40, për llogaritë

bankare me këtë përmbajtje:

llogari bankare	Banka	shoqëria ose individi
4.37.0100002314 në lekë	Banka “Raiffeisen”	shoqëria “MediCare” sh.p.k.
4.38.110006966 në USD	Banka Kombëtare Tregtare	shoqëria “Karavan” sh.p.k.
4.39.110006966 në lekë	Banka Kombëtare Tregtare	shoqëria “Karavan” sh.p.k.
4.40.110002151 në lekë	Banka Kombëtare Tregtare	shoqëria “MediCare” sh.p.k.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.28, datë 5.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.6, DATË 25.11.2005 “PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT ABDUL LATIF SALEH, I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A. SALEH, B) ABDUL LATIF SALEH, C) DR. ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A. SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH, F) ABU AMIR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Në përmbajtjen e pikës 4 germa “a”, në fund të llogarive bankare të listuara në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane) shtohet llogaria me këtë përmbajtje:

llogari bankare	shoqëria ose individi
000170 në USD	Individ Abdyl Latif A.A. Saleh

Në përmbajtjen e pikës 4 germa “a”, në fund të llogarive bankare të listuara shtohen llogaritë në Bankën Raiffeisen me këtë përmbajtje:

- Llogaritë bankare ne Bankën Raiffeissen:

llogari bankare	shoqëria ose individi
0100315426 në lekë	“Foundation of Life and Science”
801015426 në euro	Individi Abdyl Latif A.A. Saleh

2. Mbas pikës 7.4 shtohen pikat 7.5, 7.6, 7.7 me përmbajtjen si më poshtë:

7.5. Pasuria (apartament) me sipërfaqe 78 m^2 në zonën kadastrale 2315, volumi 8, faqe 236, numër pasurie 34/13+1-8 me adresë: Lagje nr.6, pallati 1, shkalla 1, kati 3, apartamenti 8, Kukës (indeksi i hartës KU-I-6).

7.6. Pasuria (truall) me sipërfaqe 98.9 m^2 në zonën kadastrale 2315, volumi 12, faqe 122, numër pasurie 39/55 me adresë: Lagje nr.3, pallati 23, apartamenti 1, Kukës. (indeksi i hartës KU-I-6).

7.7. Pasuria (apartament) me sipërfaqe 72.2 m^2 në zonën kadastrale 2315, volumi 8, faqe 146, numër pasurie 33/24+2-6, me adresë: Lagje 4, pallati 13, shkalla 2, kati 3, apartamenti 6, Kukës (indeksi i hartës KU-I-5).

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.29, datë 5.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.9, DATË 10.3.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "TAIBAH INTERNATIONAL", E NJOHUR DHE SI SHOQATA NIDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit t[organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.9, datë 10.3.2005 bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Mbas pikës 4, shtohet pikat 4.1 me këtë përmbajtje:

"Të sekuestrohet:

- Pasuria (ndërtesë) me sipërfaqe 179 m^2 e shoqatës "Taibah International", në zonën kadastrale Bulqizë me numër pasurie l/31/1 dhe numër reference 1360.
- Pasuria (ndërtesë) me sipërfaqe 340 m^2 e shoqatës "Taibah International", në zonën kadastrale Bulqizë, me numër pasurie 1/33/1 dhe numër reference 1361.
- Pasuria (ndërtesë) me sipërfaqe 207 m^2 e shoqatës "Taibah International", në zonën kadastrale Bulqizë, me numër pasurie 1/28/1 dhe numër reference 1362.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të panave", i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.30, datë 5.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.10, DATË 10.3.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "AL HARAMANIA"(AL HARAMAIN), I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.10, datë 10.3.2005 bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Mbas pikës 4, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

"Të sekuestrohet:

Pasuria "Vilë 2-katëshe" e fondacionit "Al Haramania", me sipërfaqe trualli 432 m^2 dhe me sipërfaqe ndërtimi 157 m^2 në zonën kadastrale nr.8260, numër pasurie 6/229, volumi 15, faqe 141, me adresë: rruga:"Irfan Tomini", nr.58 Tiranë.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë

15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.41, datë 9.5.2006

MBI ZËVENDËSIMIN E LEJEDREJTIMEVE TË AUTOMJETEVE, TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E KORESË

Në zbatim të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës dhe pikës 2, neni 134 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"

URDHËROJ:

1. Në kushte reciprociteti, lejedrejtimet e automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë, mund të zëvendësohen me ato të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Lëshimi i lejedrejtimeve për zëvendësimin e lejedrejtimeve të automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë, bëhet sipas përcaktimeve të nenit 134 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të lëshojë vetëm lejedrejtime të kategorisë B, për zëvendësimin e të gjitha llojeve të lejedrejtimeve të automjeteve, të lëshuara në Republikën e Koresë.

4. Lejedrejtime të motomjeteve, Class 2/Motorcycles dhe Class 2/Small, të lëshuara në Republikën e Koresë, nuk do të zëvendësohen me lejedrejtime të motomjeteve, kategoria A.

5. Tipet e lejedrejtimeve të lëshuara në Republikën e Koresë, bashkëlidhur, janë pjesë e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

URDHËR
Nr.262, datë 15.5.2006

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP PRESPË)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Prespë që i bashkëngjitet këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

VENDIM
Nr.20, datë 11.7.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 21.03.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.22 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar nga zoti Njazi Jaho, me autorizim.

2. AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar nga zoti Ermir Dobjani.

3. GRUPI SHQIPTAR I TË REJTAVE TË NJERIUT, përfaqësuar nga znj. Elsa Ballauri.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Enkelejd Alibej, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”; nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

2. Pezullimin e vendimeve të mësipërme të Këshillit të Ministrave.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 49, 107, 116, 118, 131/c, 134/dh të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 27-31 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 24 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme:

1. Në të tre vendimet e Këshillit të Ministrave janë kufizuar pa ligj të drejtat e njeriut të parashikuara në Kushtetutë duke u shkelur parimi i barazisë para ligjit, parimi i mosdiskriminimit, si dhe e drejta e punonjësve për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme që e zgjedhin ose e pranojnë vetë (nenet 17, 18 dhe 49 të Kushtetutës);

- Nga përmbajtja e dispozitave kushtetuese del se është vetëm Kuvendi që vlerëson nëse për shkak të një interesi publik ose në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve mund të kufizohen këto të drejta, duke iu përmbajtur kritereve sipas nenit 17 të Kushtetutës.

2. Nga dispozitat konkrete të ligjeve ku mbështeten vendimet, nuk rezulton që Këshilli i Ministrave të jetë ngarkuar me nxjerrjen e akteve nënligjore për të kufizuar të drejtat e shtetasve, për shkak të lidhjeve të tyre familjare, të gjinisë ose të krushqisë;

- Neni 9 i Kodit të Punës ku është mbështetur vendimi nr.43, ndalon çdo lloj diskriminimi përfshirë edhe atë për lidhje familjare.

3. Përmbajtja e vendimeve të Këshillit të Ministrave vjen ndesh me kërkesat e nenit 107 të Kushtetutës për caktimin e nëpunësve në administratën publike dhe garancitë e qëndrimit në detyrë;

- Këshilli i Ministrave u ka dhënë këtyre vendimeve efekte prapavepruese. Ato caktojnë rregulla edhe për marrëdhënie që kanë lindur para hyrjes në fuqi të tyre si dhe të ligjeve ku ato janë bazuar.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave janë një rast i pastër diskriminimi për arsye të lidhjeve familjare. Masa e largimit nga puna nuk është në proporcion me synimin që kërkohet të arrihet dhe që është lufta kundër korrupsionit. Ligji për etikën dhe ai për konfliktin e interesave mjaftojnë për kontrollin e metodave abuzive e korruptive.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar parashtroi këto shkaqe, sipas të cilave vendimet e Këshillit të Ministrave janë në pajtim me Kushtetutën:

1. Qëllimi i nxjerrjes së vendimeve diktohet nga kushtet aktuale të gjendjes së korrupsionit në dogana e tatime. Ato janë në përputhje me frymën dhe qëllimin e legjislacionit në fuqi, kryesisht me ligjin

për etikën dhe konfliktin e interesave, duke detyruar dhe bërë të zbatueshme kufizimet e vendosura në këto ligje.

2. Vendimet janë nxjerrë duke respektuar kushtet e delegimit të nenit 118 të Kushtetutës, nga organi i autorizuar dhe për çështje të përcaktuara nga ligji.

3. Nuk krijohen situata diskriminuese për faktin se ekzistojnë kushte të ndryshme si për kategoritë e fushave ku shtrihen vendimet e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për personat e veçantë. Në të dy rastet nuk kemi të bëjmë me kushte të njëjta, prandaj nuk cenohet barazia para ligjit.

4. Shprehja "vetëm me ligj" në nenin 17 të Kushtetutës nuk duhet kuptuar vetëm me ligj të Kuvendit, por edhe në bazë të ligjit. Kjo është shkronja dhe fryma e dispozitës, sepse ligji nuk shterron një çështje të caktuar dhe mund t'u lejojë shkallë diskrecioni organeve zbatuese.

5. Vendimet kanë adoptuar standarde kufizuese për lidhjet familjare, bazuar në një përligje të arsyeshme dhe objektive, në propocion me gjendjen që i ka krijuar, për interes publik dhe pa tejkaluar kufizimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e, kërkuesve, të subjektit të interesuar, dhe bisedoi çështjen në tërësi;

VËREN:

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesit evidentojnë probleme të kontrollit kushtetues në aspektin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese vlerësoi të bazuar kërkesën për pezullim të zbatimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese dhe me vendimin e datës 21.03.2006, vendosi pezullimin e tyre. Gjithashtu, ajo çmon se analiza e çështjeve që dalin në funksion të kontrollit kushtetues të këtyre akteve normative lidhet me faktin nëse vendimet e kundërshtuara kufizojnë të drejtat e njeriut dhe nëse ato janë në pajtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për këtë, është e nevojshme që të analizohen një sërë dispozitash të Kushtetutës që trajtojnë drejtpërsëdrejti problemet e ngritura ose të lidhura me to dhe sidomos nenet 4, 17, 18, 49 të Kushtetutës.

Neni 49 i Kushtetutës ka këtë përmbajtje:

"1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës".

E drejta për punë që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetues, është një e drejtë e individit në sensin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.

Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj.

Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.[1]

[1] Livio Paladini, "Diritto Constituzionale", CEDAM, Padova, 1991

2. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në radhë të parë duhet të sqarohet se, ç'kuptohet me termin ligj. Kjo për faktin se në kundërshtim me pretendimet e kërkuesve, subjekti i interesuar argumenton, se me fjalën ligj, duhet të nënkuptohen të gjitha aktet normative, pra kjo shprehje duhet kuptuar "nga dhe në bazë të ligjit".

Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues. Qëllimi i këtij neni është, që në rastin e kufizimeve, jo vetëm që duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht, organi më i lartë ligjvënës. Shprehja "vetëm me ligj" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Rastin e delegimit të kompetencave Qeverisë për aktet me fuqinë e ligjit, Kushtetuta e ka shprehur në nenin 101 duke përcaktuar edhe kriteret përkatëse të një rregullimi të tillë, gjë që nuk e ka bërë në nenin 17.

Termi "ligj" i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e fjalës ligj në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës. Nisur nga konteksti, fjala ligj, në nenin 17 të Kushtetutës, nuk ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në nenin 18 "barazia para ligjit". Kjo shprehje e fundit identifikohet me të drejtën në përgjithësi, ndërsa e para të referon në kompetencën e një organi të vetëm. Konteksti në të cilën është përdorur shprehja "vetëm me ligj" nuk lejon që të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta si në rastin në shqyrtim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në praktikën e saj.[2]

Koncepti i zgjeruar i termit ligj që përdoret në doktrinë, nuk vlen për nenin 17 të Kushtetutës. Shprehja përjashtuese "vetëm me ligj" e përdorur në nenet 11/3 dhe 17 të Kushtetutës, kanë të bëjnë me kufizime të të drejtave dhe kanë kuptim të njëjtë, atë të interpretimit të ngushtë, në dallim nga dispozitat e tjera ku fjala ligj mund të kuptohet më gjerë.

Në këtë përfundim, veç sa u përmend, arrihet edhe duke iu referuar fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 e 17 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit.

Gjykata Kushtetuese çmon se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi.

Duke përfunduar analizën e shprehjes "vetëm me ligj", parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese, vlerëson se çdo interpretim i kundërt, është padyshim një zhvleftësim i garancisë që jep Kushtetuta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe efektivisht do t'i cenonte këto liri e të drejta.

3. Përveç sa sipër, vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt kërkese, i shtrijnë efektet edhe për ato marrëdhënie që kanë lindur më parë. Në bazë të tyre, personat e punësuar në sektorët përkatës të përcaktuar në këto vendime, detyrohen të lenë vendin e punës, nëqoftëse vërtetohet shkaku i papajtueshmërisë që ka të bëjë me lidhjet nepotike apo lidhjet nepotike me pushtetin.

Nga përmbajtja e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43 e 48, del se "lidhje nepotike me pushtetin ekzistojnë apo lindin kur konkurrentët apo personeli ... kanë apo krijojnë lidhje nepotike". Kurse në vendimin nr.44, përcaktohet se "përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ekzistenca e lidhjeve ...".

Nga këto shprehje kuptohet se vendimeve u është dhënë fuqi prapavepruese, duke prekur edhe ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune para daljes së vendimeve. Antikushtetutshmëria e vendimeve nuk qëndron vetëm në faktin se vendimet e Këshillit të Ministrave kanë efekt edhe për marrëdhëniet e krijuara më parë, por dhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit, sepse punonjësve që preken nga këto vendime nuk u sigurohet punë tjetër. Sipas këtij parimi, nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një

[2] Vendimi Delcourt kundër Belgjikës, datë 23.07.1968.

individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementeve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.

Parimi i shtetit të së drejtës ku të mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues janë parimi i ndarjes së pushteteve, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike.

Sipas doktrinës, praktikimi i një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'i atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Situata ndryshon kur shteti drejtohet për të kontrolluar kushtet objektive të pranimit në një vend pune. Në këto raste, kufizimet janë të lejueshme vetëm në terma shumë të ngushta dhe të përcaktuara. Përgjithësisht, legjislatori mund të vendosë kushte të tilla vetëm kur ato nevojiten për të treguar rreziqe jashtëzakonisht shumë të mundëshme për interesa të një rëndësie thelbësore të komunitetit.[3]

Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj shprehet se "Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësorë të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohej dhe nuk mund të mbrohej materialisht".[4]

Duke iu referuar rastit konkret, lidhur me rregullimet që bëjnë tre vendimet e Këshillit të Ministrave përsa i përket efekteve prapavepruese, duhet theksuar se edhe në rast se këto kufizime do të ishin bërë me ligj, sipas kritereve të nenit 17/1 të Kushtetutës, duhej të zbatoheshin parimet e përmendura më lart.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur është e bazuar, duhet të pranohet dhe se vendimet e Këshillit të Ministrave duhen shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja "c", 134 shkronjat "dh, f" të Kushtetutës si dhe të neneve 49 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 "Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekurtimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore"; nr.44, datë 27.01.2006 "Për shmangien e nepotizmit në administratën publike" dhe nr.48, datë 27.01.2006 "Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIM I PAKICËS

Në mbështetje të nenit 131/2 të Kushtetutës dhe nenit 72/8 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe me qëllim të kultivimit në vazhdimësi të mendimit teorik për kontrollin kushtetues, po trajtoj argumentet dhe shkaqet që

[3] Donald P.Kommers "The Constitucional Jurisprudence of The Federal Republic of Germany", 2 edit, Duke University Press, Durham and London, 1997

[4] Vendimi nr.26, datë 02.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese

evidentojnë qëndrimin e kundërt me vendimin e shumicës, për të gjitha aspektet e shqyrtimit të çështjes.

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesit si dhe opinionet e paraqitura nga subjekti i interesuar, prekin çështje të pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën. Në këtë rast duhet të sqarohen një seri problemesh të lidhura dhe të ndërvarura nga njëri-tjetri, por që konvergojnë në dy aspekte kryesore ku duhet përqëndruar shqyrtimi dhe kontrolli kushtetues, për të përcaktuar nëse vendimet objekt-kërkese, kufizojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe nëse vijnë ndesh me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sqarimi i këtyre momenteve kërkon një analizë të kujdesshme të pretendimeve dhe argumenteve të ngritura, të lidhura me dispozitat e Kushtetutës që trajtojnë drejtpërsëdrejti këto probleme dhe sidomos, me nenet 17, 18, 49, 107 dhe 118 të Kushtetutës.

Nga një analizë e tillë, duke u nisur nga qëllimi që synohet të arrihet, nga përmbajtja e vendimeve, ballafaqimi i tyre me Kushtetutën dhe ligjet, por edhe nga standardet e gjithëpranuara të jurisprudencës kushtetuese, nuk më rezulton që vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt kërkese, të jenë të papajtueshme me dispozita konkrete ose me frymën e Kushtetutës dhe të Konventës, për këto arsye:

1. Kërkuesit kanë parashtruar se tre vendimet e Këshillit të Ministrave janë në shkelje të kritereve të nenit 118 të Kushtetutës, pasi ligjet ku janë referuar nuk i japin të drejtë këtij organi që të nxjerrë akte normative. Ky pretendim nuk ka asnjë bazë dhe është spekulativ. Po t'i referohesh bazës ligjore të vendimeve, ajo është e plotë, duke respektuar kushtet e delegimit të nenit 118 të Kushtetutës, sepse aktet janë nxjerrë nga organi i autorizuar dhe për çështje të përcaktuara nga ligji. Kështu, këto vendime mbështeten në nenin 100 të Kushtetutës; në nenin 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil"; në nenin 3 të ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" si dhe në nenin 9 të Kodit të Punës. Kurse vendimi nr.48, për specifikën që ka, pasi ka bërë shtesa në një vendim të mëparshëm të Këshillit të Ministrave, mbështetet edhe në dispozitat përkatëse të Kodit Doganor.

Kjo bazë ligjore nuk është thjesht formale. Duke iu referuar neneve përkatëse të ligjeve ku mbështeten vendimet, rezulton se ato autorizojnë Këshillin e Ministrave të nxjerrë akte normative në përputhje me parimet e caktuara në ligj. Neni 4/2 i ligjit për statusin e nëpunësit civil, autorizon Këshillin e Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me parimet e përgjithshme të përmendura në të. Neni 3, në pikën 1, për rregullat e etikës, shkronja "dh", përcakton se nëpunësi i administratës publike, nuk duhet të lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike dhe duhet të shmangë konfliktin e interesave. Kurse në pikën 2 të këtij neni autorizohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë rregulla në zbatim të parimeve të treguara në pikën 1. Në nenin 4, parashikohet konflikti i interesave, tregohet se ç'është dhe çfarë përfshin: lidhjet familjare, marrëdhënie biznesi ose lidhje politike. Në pikën 3 të këtij neni vihet detyrë për nëpunësin të shmangë konfliktin e interesave. Në pikën 4, përcaktohet se kandidati, për t'u punësuar në administratën publike, duhet të zgjidhë konfliktin e interesit para emërimit të tij. Kurse në nenin 5, përcaktohen kriteret e shmangies së konfliktit të interesave. Në nenin 9 të Kodit të Punës, të cilit kërkuesit i referohen pjesërisht për të argumentuar se ky nen nuk lejon diskriminimin për lidhjet familjare, ka edhe një përcaktim të tillë: "Dallimet, përjashtimet ose parapëlqimet që kërkohen për një vend pune të caktuar nuk konsiderohen si diskriminime". Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Këshilli i Ministrave ka vendosur se në sektorë të caktuar, duhen të "përjashtohen" nëpunësit që kanë lidhje nepotike dhe të "parapëlqehen" të tjerë, që nuk i kanë këto lidhje. Dallime të tilla nuk mund të konsiderohen diskriminim.

Neni 3 i ligjit për etikën, duke trajtuar shmangien e konfliktit të interesave, të referon në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Dhe kjo është e natyrshme: ligji i etikës, që ka dalë më parë, përmend në mënyrë të përgjithshme shmangien e konfliktit të interesave, kurse ai për parandalimin e tyre, bën një trajtim të gjerë e të hollësishëm të këtyre problemeve në shumë dispozita. Në nenin 37 të këtij ligji trajtohen rastet e parandalimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave, nëpërmjet dorëheqjes nga funksioni publik, transferimit si dhe marrjes së masave të nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione në të cilat ka ose mund të lindin konflikte interesash. Ky rregullim ligjor ka efekte prapavepruese për ata që janë në detyrë dhe duhet të largohen për shkak të lindjes së konfliktit të interesit, ashtu edhe për të ardhmen, duke parandaluar emërime të tilla. Vendimet e Këshillit të Ministrave kanë marrë dhe aplikuar në sektorë të veçantë pikërisht këto parime ligjore, prandaj në këtë aspekt ato janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet ku janë mbështetur. Parimi tashmë i njohur se çdo ligj ose akt nënligjor prezumohet se është në pajtim me Kushtetutën, detyron ata që pretendojnë të kundërtën të sjellin argumente bindëse dhe të qarta pse akti është antikushtetues, gjë që, në rastin konkret, nuk është bërë.

2. Për zgjidhjen e drejtë të çështjes, në radhë të parë duhet përcaktuar nëse ndodhemi në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, siç pretendohet nga kërkuesit, për kufizimin pa ligj të një të drejte të parashikuar në

Kushtetutë. Duke i qëndruar mendimit se kufizime të tilla bëhen vetëm me ligj të Kuvendit dhe në respektim të kritereve të nenit 17 (dhe në këtë pikë jam dakord me vendimin e shumicës), për rastin në shqyrtim kam bindjen se nuk kemi të bëjmë me të drejta të tilla që të zbatohet neni 17 i Kushtetutës. Për rrjedhim edhe kufizimet (që në rastin konkret ekzistojnë) si dhe komponentët e tjerë, nuk kanë atë rëndësi, konsekuencë dhe pasojë që do të kishin si pjesë përbërëse të nenit 17. Shtrohet pyetja: kufizim të kujt? Neni 17 thotë: "... të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë". Në rast se të drejtat e parashikuara nga neni 49 i Kushtetutës, janë nga ato për të cilat bën fjalë neni 17, atëherë kufizimet e vendosura janë antikushtetuese, së paku, sepse duhet të ishin bërë me ligj (pa analizuar komponentët e tjerë). Por kjo duhet parë dhe analizuar me kujdes. Neni 49 i përket vërtet Pjesës II-të të Kushtetutës, "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", por kjo pjesë është ndarë në krerë të veçantë dhe përsa i përket të drejtave vetiake, fillohet me Kreun e II-të (E drejta për jetën), Kreun e III-të (Liritë dhe të drejtat politike) dhe pastaj vjen Kreu i IV-t (Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore) ku futet edhe e drejta për punë. Kjo renditje e të drejtave duhet marrë parasysh në lidhje me mbrojtjen e tyre, si dhe në varësi të rëndësisë që kanë por, ajo në vetvete nuk e zgjidh problemin, sepse neni 17 bën fjalë për të drejtat e parashikuara në Kushtetutë.

Para se të jap mendimin nëse në këtë rast është shkelur apo kufizuar një e drejtë kushtetuese, po përmend shkurtimisht se si duhet kuptuar e drejta e parashikuar nga neni 49. Ky nen, i vendosur në kreun që përmenda më lart, nuk sanksionon të drejta e liri thelbësisht vetiake, por ofron lirinë e zgjedhjes së mjeteve të jetesës nga vetë individi nëpërmjet punës. Në këtë rast, zgjedhja, nuk është detyrim i shtetit. Ky dhe shoqëria janë të interesuar dhe kanë detyrime për të marrë masa e për të eleminuar të metat. Të drejtat e parashikuara në nenin 49, në parim nuk kanë asnjë efekt të drejtpërdrejtë, në kuptimin që kurdoherë duhet kërkuar zbatimi imediat e pa kusht i tyre. Ato nuk i japin të drejtë individit në mënyrë absolute (dhe njëkohësisht nuk ngarkojnë me një detyrim të tillë shtetin), për zënien e një posti të caktuar. Ky përfundim del nga fakti se neni 49 parashikon detyrime pozitive dhe nuk parashikon detyrime negative për shtetin siç mund të jetë për të drejtat e tjera (nenet 24-39 të Kushtetutës).

Në dallim edhe nga disa të drejta të tjera të përfshira në këtë Kre, siç janë ato të parashikuara nga nenet 53 (Martesa dhe Familja), 54 (Fëmijët, Gratë shtatzëna), 55 (Kujdesi shëndetësor), ku përcaktohet se kanë mbrojtje të veçantë ose kujdes nga shteti, e drejta e parashikuar nga neni 49 nuk e ka një kusht të tillë. Prandaj, edhe për këtë arsye, ajo nuk duhet kuptuar si liri negative.

Në vazhdim të këtij arsyetimi na vjen në ndihmë edhe neni 38/2 i Kushtetutës, që ka këtë përmbajtje: "Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit". Ky formulim është i njëjtë me atë të nenit 2/2 të Protokollit 4, sipas të cilit: "Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend duke përfshirë të tijin". Këtu ndryshimi është vetëm në mënyrën e formulimit: sipas Protokollit është formulim i qartë pozitiv, sipas Kushtetutës, formulimi në dukje është negativ, por që në fakt duhet të ishte dhe është pozitiv. Kjo, sepse nuk mund të thuhet dhe as të pranohet se aktualisht (por edhe për një periudhë kohe) daljet jashtë shtetit janë krejtësisht të lira dhe për cilindo. Për ta bërë më të qartë argumentin, po i referohem përmbajtjes së nenit 26 të Kushtetutës, për ta krahasuar me nenin 49. Shprehja në nenin 26 se "Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar …", përbën një formulim negativ dhe është antipodi i nenit 49, jo vetëm si mënyrë formulimi, por edhe në përmbajtje. Mosrespektimi i këtij neni, cenon një të drejtë kushtetuese, gjë që s'mund të thuhet për të drejtën e parashikuar nga neni 49.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Titullin I-rë, "Të drejtat dhe liritë"(nenet 2-14), megjithëse trajton lirinë e tubimit dhe të organizimit (neni 11), nuk e përmend fare të drejtën për punë, duke lënë të kuptohet se kjo e drejtë ka një rregullim tjetër, relativ, në krahasim me të drejtat dhe liritë e përmendura. Ky status juridik i të drejtave ekonomike, sociale e kulturore, bën që disa të shprehen se ato nuk janë aspak të drejta të vërteta [5], ose të konsiderohen si të drejta programatike.[6]

Ky konkluzion rrjedh edhe nga standardet teorike e praktike të shumë vendeve sipas të cilave, këtu kemi të bëjmë jo vetëm me detyrimet pozitive të shtetit, por edhe formulimi i të drejtave të tilla bëhet në mënyrë relative dhe ato mund t'u nënshtrohen kritereve përjashtuese, për interes publik etj. Gjykata Kushtetuese e Rusisë, në vendimin e saj datë 27 dhjetor 1999, trajton çështjen lidhur me të drejtat ekonomike, sociale e kulturore dhe duke iu referuar Konventës nr.111, të vitit 1958 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), shprehet se dallimet, përjashtimet ose parapëlqimet në fushën e punësimit, bazuar në kërkesa të veçanta të vendit të punës, nuk konsiderohen diskriminim. Sipas Gjykatës Kushtetuese

[5] C. Krause and A. Rosas, "Economic, Social and Cultural Rights", Martin Nijhoff Publishers, Netherlands, 1995, f.17.

[6] H. Steiner and Ph.Alston, "International Human Rights in Context": Law, Politics and Morals. Oxford, 2002/2003, f.245.

të Rumanisë, rregullimi i kushteve të ushtrimit të një profesioni dhe vendosja e disa papajtueshmërive, nuk përbëjnë një kufizim të së drejtës së punës. Kufizimet e parashikuara nga ligji, janë thjesht kushte që aplikohen ndaj personave që kërkojnë të marrin statusin e llogaritarit publik, të njëjta me kushtet që kanë të bëjnë me arsimin ose vjetërsinë e shërbimit dhe si të tilla nuk janë kufizim i të drejtave kushtetuese të caktuara (vendimi datë 06.06.2002).

Gjithësesi, vendosja e disa kritereve për ushtrimin e një profesioni nuk është diskriminim përkundrazi, është kusht themelor për zbatimin e parimeve kushtetuese në një shtet ligjor. Në një shoqëri demokratike, nuk ka dhe nuk mund të ketë liri të pakufizuara që vinë ndesh me parimet kushtetuese. Në këtë vështrim, referimi i kërkuesve në nenin 49 të Kushtetutës është i gabuar dhe pa bazë. Ky nen nuk i garanton detyrimisht individit një punë të caktuar. Ai mund ta humbasë vendin e punës (siç ndodh jo rrallë për arsye nga më të ndryshmet), por ka të drejtë dhe mundësi reale të zgjedhjes së një vendi tjetër pune në kushtet e ekonomisë së tregut. Nuk mund të vihet shenja e barazimit mes të drejtës të parashikuar nga neni 49, me atë që quhet e drejtë për një vend të caktuar pune siç pretendon kërkuesi, prandaj nuk ka shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese, nuk ka as kufizim sipas kritereve të nenit 17 të Kushtetutës.

3. Kam mendimin se çështja paraqet interes dhe në një aspekt tjetër. Duke mos patur shkelje të së drejtës të parashikuar nga neni 49 dhe as kufizim sipas nenit 17, bie pretendimi për antikushtetutshmëri të vendimeve lidhur me këto nene, por mbetet për t'u analizuar në lidhje me nenin 107 të Kushtetutës, sipas pretendimeve të kërkuesit. Në bazë të këtij neni, nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuar nga ligji dhe se garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i tyre rregullohen me ligj. Çështjet që dalin nga ballafaqimi i përmbajtjes së tre vendimeve të Këshillit të Ministrave me këto garanci kushtetuese, janë të shumta dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra. Gjithësesi, përcaktimi kushtetues nuk e redukton rregullimin e këtyre problemeve vetëm me ligj, në kuptimin që nuk duhet të ketë rregullim të mëtejshëm me akte nënligjore. Përkundrazi, rregullimi me akte të tilla mund dhe duhet të bëhet, me kusht që të respektohen kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës: autorizimi i ligjit, organi kompetent, çështjet që duhen rregulluar etj. Këto kushte plotësohen, siç e përmenda më lart (pika 1), prandaj mbetet që çështja të trajtohet më gjerë lidhur me përmbajtjen dhe kufizimet që mbartin vendimet e Këshillit të Ministrave dhe nëse ato cenojnë parime kushtetuese.

Nga përmbajtja e tre vendimeve të Këshillit të Ministrave, del se ato përcaktojnë kritere përjashtuese, të cilat përbëjnë kufizime për individë të veçantë, por jo kufizime në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Me të drejtë shtrohet pyetja: këto përcaktime ose kufizime a krijojnë situata diskriminuese ose vënie në pozita të pabarabarta? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të nisemi nga standardi i gjithëpranuar, i adoptuar edhe nga Gjykata Kushtetuese Shqiptare dhe që tani përbën, një maksimë: që barazia në ligj dhe para ligjit duhet evidentuar vetëm kur janë kushte të njëjta dhe jo në situata të ndryshme. "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë objektivisht në kushte të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta".[7] Në një vendim tjetër,[8] kjo Gjykatë konfirmon këtë fakt, duke nënvizuar se ky përbën edhe një qëndrim tashmë të konsoliduar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Kurse në vendimin, nr.171, datë 30.07.2002, arrihet në përfundimin se neni përkatës i ligjit për statusin e deputetit nuk është në kundërshtim me Kushtetutën "për faktin se deputetët dhe konkuruesit e tjerë kanë pozita të ndryshme me njëri-tjetrin dhe për pasojë, përjashtimi i ish-deputetëve nga konkurimi, i bërë pikërisht për shkak të pozitës së tyre, nuk cenon parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe as nuk përbën ndonjë formë të veçantë diskriminimi". Edhe Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, duke trajtuar parimin e barazisë para ligjit, në një vendim të saj shprehet: "Një kuptim ekstrem i barazisë, pa marrë në konsideratë natyrën specifike të një gjendjeje të veçantë aktuale ose ligjore, në fakt të çon në pabarazi".[9]

Po t'i referohemi vendimeve të Këshillit të Ministrave, kam mendimin se ato sigurojnë trajtim të njëjtë në situata të njëjta dhe, sigurisht, të ndryshme në situata të ndryshme. Këto situata të ndryshme janë evidentuar si për kategori subjektesh, ashtu edhe për individë të veçantë. Në lidhje me kategoritë, është fakt se vendimet shtrihen jo në të gjithë sektorët, por vetëm në tre (dogana, tatime, administratë publike). Për këtë të fundit, duhet sqaruar se papajtueshmëria është pengesë vetëm brenda të njëjtit institucion dhe nuk shtrihet ndërmjet institucioneve të administratës publike. Kjo është e rëndësishme të evidentohet për të kuptuar karakterin dhe pasojat relativisht të kufizuara që rrjedhin nga zbatimi i vendimit.

Duke e parë çështjen në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se shkelet parimi i barazisë dhe krijohen situata diskriminuese në raport me kategoritë e tjera, që i përkasin sektorëve të tjerë, sepse nuk janë në të njëjtat kushte. Sipas vendimit të Këshillit Kushtetues të Francës: "Parimi i barazisë së trajtimit në

[7] Vendimi nr.11, datë 27.08.1993, i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.
[8] Vendimi nr.16, datë 17.04.2000, i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.
[9] Vendimi nr.57, viti 1992, i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë

zhvillimin e karrierës së nëpunësve, zbatohet vetëm për nëpunsit që i përkasin të njëjtës kategori".[10]

Nga një vështrim krahasues i pozitës së individëve brenda kategorive të prekura nga vendimet e Këshillit të Ministrave, rezulton se edhe këtu kushtet nuk janë të njëjta. Nëpunësit brenda kategorive përkatëse (dogana, tatime ose brenda një institucioni publik), në raport me nëpunësit e tjerë brenda të njëjtave kategori, kanë pozita objektive të ndryshme nga njëri-tjetri, pra nuk janë në kushte të njëjta. Pikërisht pozita e ndryshme e të parëve, e krijuar nga fakti i lidhjeve nepotike, bëhet shkak për marrjen e masave përkatëse në zbatim të vendimeve. Në këtë rast nuk cenohet parimi kushtetues i barazisë para ligjit, përkundrazi, rivendoset barazia që ishte cenuar faktikisht nga pozita e privilegjuar e atyre nëpunësve që gëzojnë lidhjet nepotike.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shprehet në lidhje me diskriminimin se megjithë që përcaktimi në nenin 14 të Konventës nuk është shterues, përsëri i duhet lënë hapësirë vlerësimi Shteteve Palë, duke theksuar se ai (diskriminimi) është i bazuar po të zbatohen tre teste ose kritere: 1. Të ketë një përligje të arsyeshme dhe objektive, 2. Të ndjekë një qëllim legjitim, dhe 3. Të ketë një proporcion të arsyeshëm mes masave të marra dhe qëllimit që synohet të arrihet.[11]

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka adoptuar në praktikën e saj doktrinën e hapësirës së vlerësimit (the margin of appreciation), si një arritje e përgjithshme në detyrën aq delikate për të balancuar ushtrimin e sovranitetit të Palëve Kontraktuese me detyrimet e tyre sipas Konventës. Dilema që e shqetësonte këtë Gjykatë, e bërë evidente në çështjet ku shfaqej mundësia e zbatimit të kriterit të vlerësimit, ishte se si të mbetej besnike në përgjegjësinë e saj për të zhvilluar një serë parimesh që rrjedhin nga Konventa dhe, në të njëjtën kohë, të njihte diversitetin e situatave politike, ekonomike, sociale e kulturore në Shtetet Palë Kontraktuese. Doktrina e hapësirës së vlerësimit aplikon një element të relativitetit në interpretimin uniform të Konventës, në varësi të rrethanave të çështjes konkrete. Ajo e ka burimin në faktin se organet e brendshme të një vendi, janë më afër gjendjes, problemeve e shqetësimeve të shoqërisë e të shtetit dhe i njohin ato më mirë se sa institucionet ndërkombëtare.

Nga zbatimi i kritereve të kësaj doktrine, arrihet në përfundimin se jo çdo diskriminim në kushte të veçanta, mund të përbëjë shkelje të Konventës, sepse për të mund të ketë arsye të përligjura. Në çështjen Abdulaziz etj.,[12] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e zgjeron hapësirën e vlerësimit për shtetin, jo vetëm në kuptim të zbatimit të një të drejte pozitive, por edhe në atë nëse ekziston vetë e drejta, duke argumentuar se në raste të tilla, Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi, një vlerësim të dyfishtë të nevojave e kërkesave të komunitetit dhe të individëve për t'u përshtatur me Konventën. Në këtë çështje, Gjykata shprehet se hapësira e vlerësimit përdoret jo vetëm për të balancuar të drejtat e individit dhe të komunitetit, por edhe për të vlerësuar nëse ekzistojnë rrethana që përligjin trajtimin e një grupi në mënyrë më të favorshme se një grup tjetër. Kjo Gjykatë pranon, gjithashtu, se nga një analizë e veçantë, e detajuar e fakteve të çështjes konkrete, të subjektit dhe rrethanave në tërësi, arrihet të përcaktohet objektiviteti dhe arsyeshmëria e shkeljeve të lejuara.[13] Në lidhje me këtë, Prof.Gustavo Zagrebelsky, kryetar nderi i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, shprehet se "Komunikimi ndërmjet doktrinave presupozon ekzistencën e një shkalle të caktuar elasticiteti në interpretimin kushtetues, pra me fjalë të tjera të një autoriteti diskrecional. Në rastet kur kjo gjë mungon, i gjithë argumentimi i përmendur më sipër nuk do të kishte vlerë".[14]

Kur parashtroj këto argumente, nuk do të thotë se jam i mendimit që këto të drejta nuk duhet të mbrohen dhe nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, por ky i fundit, duhet të ketë parasysh faktin që duke qenë të drejta të tilla (jo absolute), kufizimet dhe diferencimet që e kanë mbështetjen në nenet përkatëse të Kushtetutës, të jenë të tilla që të përligjen në bazë të tre testeve që përcakton Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga ana tjetër, vlen të theksohet se sikur të mos mjaftonte shprehja "padrejtësisht" në nenin 18/2 të Kushtetutës, (gjë që do të thotë se "drejtësisht", në mënyrë të përligjur, ky diskriminim lejohet), në pikën 3 të këtij neni, me shprehjen "nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive", Kushtetuta ka pranuar qartë se në kushte të caktuara lejohet diskriminimi, ose e thënë më thjesht, dallimi i përligjur.

Në këtë kuptim, vendimet e atakuara kanë një përligjie objektive dhe të arsyeshme, nisur nga qëllimi i mirë për të luftuar nepotizmin, korrupsionin etj. Në vështrim të nenit 18/2 të Kushtetutës, ato nuk përbëjnë diskriminim të padrejtë dhe nuk prekin parimin e barazisë para ligjit. Vlen të theksohet se këto

[10] Vendimi datë 15.07.1976, i Këshillit Kushtetues të Francës.
[11] Cituar sipas "The European System for the Protection of Human Rights", R. Macdonald, F. Matscher and H. Petzold, botim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ed. Anglisht, f.118.
[12] Vendimi 28 maj 1985, Seria A, Nr.87 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
[13] Çështja Rasmussen, Seria A, Nr. 87.
[14] Fjala në ceremoninë zyrtare të 50-vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese, Romë, Maj 2006.

vendime nuk i konsiderojnë lidhjet familjare apo përkatësinë prindërore si pengesë potenciale dhe apriori, se ajo që krijon papajtueshmëri nuk është ekzistenca e lidhjes familjare në përgjithësi, por fakti i lidhjeve të tilla të një individi me funksion të caktuar me një tjetër që ushtron detyra po kaq të përcaktuara, të cilat në parim vijnë ndesh me ligjin e etikës dhe atë për shmangien e konfliktit të interesave.

I rëndësishëm është fakti se ndonëse në pamje të parë duket sikur vendimet e Këshillit të Ministrave kanë përcaktuar rregulla të reja sjelljeje, realisht ato nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë zhvilluar më tej dhe kanë detajuar më qartë kriteret përjashtuese të vendosura më parë me ligje të veçanta. Në nenin 4/4 të ligjit për rregullat e etikës në administratën publike, përcaktohet se konfliktet e mundshme të interesit të një kandidati për t'u punësuar në administratën publike, duhet të zgjidhen përpara emërimit të tij. Kurse në nenin 37 të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, parashikohet që zgjidhja e situatave të konfliktit të interesave, bëhet nëpërmjet transferimit të nëpunësit, apo nëpërmjet marrjes së masave për shmangien e emërimit ose zgjedhjes.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, (por edhe të tjera), del se është ligjëruar kufizimi i disa të drejtave me qëllim shmangien e konfliktit të interesave, me anë të mosemërimit apo transferimit në një punë tjetër. Të dy këto ligje, si ai i etikës dhe i konfliktit të interesave, kanë harmoni të plotë. I dyti zbërthen në një nivel më të lartë konceptin e konfliktit të interesave si dhe përcakton kufijtë dhe mënyrën e trajtimit të tij. Në këtë rast, nxjerrja e akteve nga Këshilli i Ministrave është një e drejtë e këtij organi për të vendosur rregulla të detyrueshme për shmangien e konfliktit të vazhdueshëm të interesave që jo vetëm buron nga këto ligje, por njëkohësisht përbën edhe një kontribut për zbatimin e mëtejshëm të tyre.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesve se akteve nënligjore nuk mund t'u jepet fuqi prapavepruese, ai nuk ka bazë ligjore. Sipas nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative, aktet administrative kanë fuqi prapavepruese, ndër të tjera edhe kur një gjë e tillë lejohet nga ligji. Në fakt, ligjet ku mbështeten vendimet e Këshillit të Ministrave e lejojnë dhe kërkojnë një rregullim të tillë.

Veç analizës në kuadrin e kontrollit kushtetues, duhet përmendur se vendimet e Këshillit të Ministrave kanë dalë në një kohë (dhe për një qëllim madhor) kur organet dhe organizmat ndërkombëtare kanë vënë theksin në domosdoshmërinë e luftës kundër korrupsionit e nepotizmit si kusht për forcimin e shtetit ligjor. Në raportin e OECD-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), Dhjetor 2004, përmendet se korrupsioni përbën një nga pengesat më serioze për një zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe për më tepër, nepotizmi, patronazhi politik dhe ryshfeti, janë të zakonshme. Në raportin e SIGMA-s për Shqipërinë, viti 2004, vihet në dukje se niveli i korrupsionit, përfshirë nepotizmin dhe klientelizmin, e pengon sistemin e shërbimit civil që të zhvillojë kapacitetet e tij njerëzore dhe funksionimin administrativ. Eshtë e qartë se kjo gjendje ka shtruar nevojën për të ndërmarrë një nismë antinepotike, që u konkretizua me nxjerrjen e tre vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Nepotizmi dhe lufta kundër tij nuk është fenomen vetëm shqiptar. Kudo në botë ka shembuj të shfaqjeve të tilla si dhe përpjekje për t'i minimizuar me forma e metoda nga më të ndryshmet, të cilat dallojnë nga një shtet në tjetrin dhe nga koha në kohë. Por, e përbashkëta qëndron në mospajtimin me këtë fenomen, i cili mund të jetë toleruar përkohësisht deri sa përmasat shqetësuese kanë detyruar shtetin të ndërhyjë me forcën e ligjit. Në gjyqësorin e Brazilit janë konstatuar shembuj absurdë të nepotizmit si emërimi nga kryetari i gjykatës federale të Amazonës të djalit të tij në postin e drejtorit po në atë gjykatë; nga një kontroll i bërë në vitin1999 në shtetin Paraiba, rezultoi se 160 nga 565 punonjës të gjykatave ishin të afërm të gjyqtarëve shtetërorë dhe vetëm kryetari i Gjykatës së Lartë kishte punësuar shtatë fëmijë të tij; kurse një gjyqtar i gjykatës federale të punës në shtetin Paraná, punësoi jo më pak se 63 të afërm të tij, përfshirë gruan dhe katër fëmijët. Një situatë e tillë e detyroi Kongresin të nxirrte një ligj që ndalonte gjyqtarët federalë të punësonin të afërmit e tyre.[15]

Nën dritën e mendimit të konsoliduar doktrinal dhe të jurisprudencës kushtetuese të vendit tonë dhe asaj ndërkombëtare (një pjesë e vogël e të cilave ilustrojnë këtë mendim pakice), kam përshtypjen se argumentet e kundërta që përdoren nga kërkuesit dhe të pranuara me vendim të shumicës, për t'i konsideruar vendimet e Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën, nuk mund t'i qëndrojnë debatit teorik, që bazohet në kriteret e gjithëpranuara e objektive dhe jo nga pozitat e kriticizmit formal.

Në aspektin e përmirësimit të përmbajtjes së normave, do të ishte me vend që vendimet e Këshillit të Ministrave të përmendnin shprehimisht transferimin në një punë tjetër për raste të tilla, por kjo mangësi nuk i bën ato antikushtetues, për faktin se transferimi është parashikuar në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, i cili, në bazë të kriterit të hierarkisë së akteve normative, zbatohet drejtpërsëdrejti pa sjellë ndonjë pasojë.

Përfundimisht shpreh bindjen se vendimet e Këshillit të Ministrave për shmangien e nepotizmit

[15] Augusto Zimmermann, "Has the Brazilian Judiciary Became a Mafia?", Brazil Magazine, 4.01.2005.

janë në përputhje me Kushtetutën jo vetëm nga qëllimi i mirë që synojnë të arrijnë, por edhe për arsye të tjera substanciale, sepse kanë dalë në bazë e për zbatim të ligjeve, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, janë në përputhje me frymën dhe qëllimin e tyre (ligji për etikën dhe parandalimin e konfliktit të interesave), nuk vendosin kufizime të reja, por detajojnë dhe bëjnë të zbatueshme kriteret përjashtuese të përcaktuara në këto ligje që u përmendën.

ANËTAR
K. Peçi

Tiranë, më 11.07.2006

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)……**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)**	**1500**
4.	**PËR TAKSAT DHE TATIMET…(+ suplement 2006)……**	**1500**

1.	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT……**	**1500**
2.	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT……**	**2000**

Botime të reja

1.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……**	**500**
2.	**KODI DOGANOR……...**	**1000**
3.	**KODI DETAR ……**	**1000**

Hyri në shtyp më 12.7.2006
Doli nga shtypi më 14.7.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë